

Zgjidhje për mbrojtjen

Dardha



Zgjidhje për mbrojtjen

Dardha

Dëmtuesit

Psilla

PROBLEMI

Psilla (*Cacopsylla pyri*) është një nga insektet më të dëmshëm në të gjitha zonat e kultivimit, sidomos në varietetet William, Abate Fetel, Conference dhe Decana. Stadet më të dëmshme janë ato të reja, sepse, përveç dëmit që shkaktojnë nga thithja e lëngjeve, lëshojnë sasi të mëdha lëndësh sheqerore, të cilat mbulojnë pjesët e gjelbra të bimëve (kështu pengojnë fotosintezën dhe frymëmarrjen) dhe frutat, të cilat humbasin vlerën tregëtare si rezultat i mykut të zi që zhvillohet mbi ta. Përveç kësaj, të dy statet; të rinj dhe të rritur, mund të jenë bartës të ftoplasmave.

ZGJIDHJA

Zakonisht luftohet breznia e dytë e psillës (në përgjithësi në fillim - në mes të majit) dhe është shumë i rëndësishëm përdorimi i insekticideve selektive ndaj çimkës predatore (*Anthocoris nemoralis*), që është faktori kryesor kufizues natyral i psillës. Luftimi i psillës është i vështirë për arësye të mbivendosjes së shpeshtë të fazave të ndryshme të zhvillimit (vezë, nimfa të moshave të ndryshme dhe madje edhe insekte të rritur), por sidomos për produktet e pakta me efektivitet të mjaftueshëm dhe selektive ndaj artropodëve të dobishëm, që janë në dispozicion.

Përqëndrohu në:

MOVENTO

Movento është insekticidi i vetëm me veprim sistemik të dyfishtë; lëviz në drejtimin lart dhe poshtë. Movento, në sajë të lëvizjes së dyfishtë hyn në sistemin e qarkullimit dhe arrin në të gjitha organet e bimës: gjethet të reja dhe në zhvillim, sytha, fruta dhe madje edhe rrënjë. Trajtimi kur vezët marrin ngjyrë të verdhë, siguron efektivitet të lartë dhe kohëzgjatjen e mbrojtjes; për më tepër, në sajë të selektivitetit të Movento, nuk ndërhyr në zhvillimin e çimkës predatore që luan një rol të rëndësishëm si kufizuese natyrale e psillës. Movento siguron efektivitet të lartë edhe në rast të pranisë së fazave të ndryshme të zhvillimit të psillës dhe prekjës edhe nga afidet e breshkëzat.



MOVENTO[®]
100 sc

Koha: - kundër breznsisë së dytë, në fazën e vezës së verdhë

Doza: 1.5 - 2.2 L/ha, i përzierë me vaj mineral (250 ml/100 L ujë).

Shënim: efektiv edhe ndaj afideve e breshkëzave
Shënim: Mund të shpëtohet edhe vaj breshkëzave


Dëmtuesit

Breshkëzat

PROBLEMI

Specia më e rëndësishme për pemet frutore farore është breshkëza e Kalifornisë (*Quadraspidiotus perniciosus*). Femrat e rritura linden nimfat, të cilat janë të lëvizëshme dhe shpërndahen në bimën e prekur. Kjo është faza e vetme e ndjeshme ndaj pesticideve.

Përveç dëmit të shkaktuar nga thithja e limfës, në shumë raste, organet e atakuara (veçanërisht frutat) reagojnë ndaj futjes së pështymës duke krijuar njolla e lenticelle si dhe dalin lëndë sheqerore mbi të cilat formohet myk i zi.



MOVENTO®
100 sc

Koha: me fillimin e migrimit të larvave të reja

Doza: 150ml/100 L ujë (1.5-2.2 L/ha)

Shënim: Mund të shtohet edhe vaj mineral

Këpushat

PROBLEMI

Këpushat janë insekteve që i përkasin nënklasës së araknideve. Më të dëmshmet në fruta mund të grupohen në dy kategori : tetranikide (*Panonychus ulmi*, *Tetranychus urticae*) dhe eriofde (*Aculus schlechtendali*).

Simptomat shfaqen në gjethe të cilat dehidratoohen, marrin ngjyrë bronzi, zverdhen dhe bien herët ndërsa në fruta krijohen zona me ngjyrë ndryshku.

Zhvillimi i këpushave mund të kontrollohet pjesërisht nga grabitqarë të shumtë; për këtë arsye është e rëndësishme të përdoren produkte selektive.

envidor®
240 SC

Koha: Me shfaqjen e nimfave të para lëvizëse

Doza: 600 ml/ha

Shënim: Lufton edhe breshkëzat



Dëmtuesit

Krimbi

PROBLEMI

Krimbi i mollës (*Cydia pomonella*) është dëmtuesi më i përhapur dhe më i rrezikshëm për pemët frutore farore. Dimëron në stadin e larvave të rritura dhe ka 1-3 brezni në vit, në varësi të kushteve mjedisore.

Vezët e breznisë së parë vendosen në gjethe, në afërsi të frutave të vegjël, kurse ato të brezive pasardhëse, direkt mbi fruta.

Larvat e breznisë së parë kanë një fazë të shkurtër "endacakërie" para se të depërtojnë në fruta .

Dëmtimet në pjeset vegetative janë të parëndësishme, ndërsa ato në fruta, janë shumë serioze.

Prej disa vitesh, vërehet kalimi i tenjës së lindjes (*Cydia molesta*) nga pjeshkët në pemë frutore farore, në afërsi të kohës së vjeljes.

ZGJIDHJA

Trajtimet për luftimin e krimbit të mollës duhet të bazohen mbi prognozën. Për këtë, mund të bëhet monitorimi i popullatës me kurthe seksuale .

Momenti i ndërhyrjes ndryshon në varësi të produktit që do përdoret dhe mbrojtja mund të integrohet me metodën e konfuzion seksual.



Koha: nga fillimi i fluturimit, deri në fillim të vendosjes së vezëve
Doza: 40-50 ml/100 L ujë (0,4-0,5 L/ha)

calypso®

Koha: fillimi i çeljes së vezëve
Doza: 25 ml/100 L ujë
Shënim: Efektiv edhe ndaj afideve.



Dëmtuesit

Tortricidet

(Qëndistarët)



PROBLEMI

Qëndistarët janë një grup lepidopterësh tortricide, të quajtur kështu për dëmtimin karakteristik të shkaktuar nga larva në sipërfaqe të gjetheve dhe frutave.

Ju përkasin gjinive dhe specieve të ndryshme: *Pandemis heparana*, *Pandemis cerasana*, *Pandemis dumetana*, *Archips podaná*, *Adoxophies orana*, *Argyrotaenia pulchellana*.

Dëmet vërehen shpesh në pikat e kontaktit midis frutave ose, më shpesh, midis një fruti dhe një gjetheje.

Veze vendosen në grupe dhe ngjiten nga një sekrecion transparent.

Shumica e specieve dimërojnë në stadin e larvave përveç *Argyrotaenia pulchellana* që dimëron si pupë.



Koha: -larvat dimëruese; para ose pas lulëzimit

-breznitë pranverore-verore; me fillimin e vendosjes së vezëve

Doza: 40-50 ml/100 L ujë (0,4-0,5 L/ha)

caLypso®

Koha: -larvat dimëruese; para ose pas lulëzimit

-breznitë pranverore-verore; me fillimin e vendosjes së vezëve

Doza: 25 ml/100 L ujë



Dëmtuesit

Grerëza e dardhës (*Hoplocampa brevis*)



PROBLEMI

Femra i vendos vezët në lulëri. Larvat depërtojnë në lule dhe ushqehen me frutat e vegjël të sapolidhur. Frutat e vegjël gërryhen plotësisht dhe deformohen nga larvat të cilat në përfundim bien në tokë ku qëndrojnë deri pranverën tjetër.

 Confidor^{200 SL}

Koha: fillimi i çeljes së vezëve

Doza: 50 ml/100 L ujë

Shënim: Efektiv edhe ndaj afideve dhe minatriçeve



Krimbi i degëve (*Zeuzera pyrina*)

PROBLEMI

Prek dardhën, mollën dhe më pak pemët e tjera frutore e pyjore. Prek degët e holla dhe pemët e reja tek të cilat, shpesh, edhe një larvë e vetme mund të shkaktojë tharjen. Ka 1 brezni në 2 vjet, por, në kushte dhe zona të caktuara, mund t'a plotësojë ciklin e zhvillimit edhe brenda vitit.

Dimëron në stadin e larvës. Në Maj -Qershor (sipas kushteve) larvat krisalidohen në galeritë e formuara dhe pas rreth 3 javësh dalin fluturat të cilat vendosin vezët në plasaritjet e lëkurës, në vendet e degëzimit ose në afersi të sythave. Mbas rreth 2 javësh dalin larvat që në fillim janë të ekspozuara dhe më vonë formojnë galeri.

Dëmi fillestar mund të ngatërrohet me atë të shkakuar nga tenja (*Anarsia lineatella*).



Koha: Në kohën e fluturimit maksimal të insektit të rritur

Doza: 40-50 ml/100 L ujë (0,4-0,5 L/ha)

Sëmundjet

Njolloosja kafe

(*Stemphylium vesicarium*)



PROBLEMI

Sëmundja prek gjethet dhe frutat, ku shkaktohet edhe dëmi më i madh nga pikëpamja ekonomike.

Mbi gjethe shfaqen njolla me ngjyrë kafe të cilat thahen dhe përhapen duke mbuluar gjithë gjethen dhe shkaktuar rënien e saj .

Mbi fryta shihen fillimisht njolla kafe të rumbullakëta, ndonjëherë të thelluara, të rrethuara nga një aureolë e kuqe rreth zonës së prekur.

ZGJIDHJA

Mbrojtja duhet të filloje nga prekjet e para që fillojnë në fazën e lulëzimit - lidhjen e frutave dhe bëhen më të qarta më vonë në gjethe dhe në frutat në rritje deri në fazën e vjeljes.

NATIVO
75 WG

Koha: para lulëzimit deri para vjeljes

Doza: 20 g/100 l ujë (300 g/ha)

Luna
EXPERIENCE

Koha: nga lulëzimi deri në përfundim të rritjes së frutave

Doza: 50 ml/100 L ujë (0.75 L/ha)

ZATO

Koha: trajtme parambrojtese ne interval 7-10 ditë

Doza: 15 g/100 l ujë

Përqëndrohu në

LUNA EXPERIENCE

Luna Experience bazuar në Tebuconazole dhe Fluopyram, është një fungicid i ri me spektër të gjërë për luftimin e sëmundjeve në shumë kultura frutore dhe veçanërisht kromës dhe hirit në mollë. Fluopyram është një lëndë e re aktive për luftimin e sëmundjeve të pemëve frutore, e cila sulmon kërpudhat nga mbirja e sporeve deri në sporulim. Ngjitet mirë në sipërfaqe të indeve, pastaj futet brenda tyre në mënyrë progresive me lëvizje traslaminare dhe akropetale. Ka rezistencë të shkëlqyer ndaj shpëlarjes nga shirat.

Sëmundjet

Kroma



PROBLEMI

Sëmundje shumë e rrezikshme dhe e dëmshme; prek gjethet, lastarët dhe frutat.

Shfaqet në fushë ose në ruajtje. Periudhat më të rrezikshme për zhvillimin e infeksioneve janë në lulëzim dhe menjëherë pas tij, kur janë kushtet e lagështisë dhe temperaturës ideale për zhvillimin e patogjenit. Prekje të mëtejshme mund të ketë gjithashtu në fund të verës. Këto shkaktojnë dëmtimin e frutave

ZGJIDHJA

Mbrojtja nga kroma duhet të bëhet në bazë të një kalendarit trajtimesh parambrojtëse për të gjithë sezonin, nga hapja e sythave dhe rritja e frutave deri në vjelje.

Antracol
70 WG

Koha: trajtimit parambrojtëse menjëherë pas lulëzimit
Doza: 150 g/100 l ujë (2.25 kg/ha)

Luna
EXPERIENCE

Koha: nga lulëzimi deri në pjekje
Doza: 0.75 L/ha

Folicur EW 250

Koha: trajtimit parambrojtëse ose menjëherë pas shenjave të para
Doza: 40 - 50 ml/100 L ujë
Shënim: Efektiv edhe ndaj njollosjes kafe



Sëmundjet

Bakteriozat



PROBLEMI

Sythat vegjetative marrin ngjyrë kafe, thahen dhe bijen nga dega; në lule vërehet nxirje e kurorës dhe nekrozë e bishtit të saj. Kjo mund të vërehet shpesh në gjithë lulërinë. Në degëza shfaqen shenja kanceroze në pikat e takimit me degët, ndërsa gjethet e prekura kanë njolla të rumbullakosura me ngjyrë të zezë dhe deformim; në frutat e vegjël infeksioni shfaqet me njolllosje të zeza me konture të parregullta.

Disa shtame të *Pseudomonas syringae* kanë aftësinë të prodhojnë proteina të afta të shkaktojnë formimin e akullit dhe ta mbajnë atë në temperaturë -2°C ; kështu dëmtohet indi nën akull dhe krijohen kushtet që bakteriet të sigurojnë lëndë ushqimore të gatshme. Këto shtame zhvillohenngadalë edhe në temperaturën -1.5°C dhe mbijetojnë përkohësisht në ushqimin e ngrirë.

Aliette

Koha: 200-250 g/100 L ujë; 3-4 trajtime në periudhën prill-qershor, ose 50 g/100 L ujë me trajtime javore në të njëjtën periudhë.

Shënim: efikas edhe për luftimin e njolllosjes kafe (*Stemphylium vesicarium*)



Kanceri i degëve

PROBLEMI

Simptomat e para janë pika (njolla) të thellëzuara mbi organet drunore të pemës.

Pjesa e sëmurë nekrotizohet, ndërsa anës saj formohen barriera shërimi (pjesë të cikatrizuara) që pengojnë përhapjen e patogjenit drejt pjesëve të shëndetshme. Në disa zona me lagështi të lartë, sëmundja mund të prekë frutat në të cilat formohen njolla të kuqe ose kafe në afërsi të zgavrës së farave, sidomos pas vjeljes.

Trajtime parambrojtëse me produkte me bazë bakri

Barërat
e këqija



Barërat dhe thithakët

PROBLEMI

Luftimi i mirë i barërave të këqija dhe thithakëve në pemëtore është një praktikë e rëndësishme për të siguruar rritjen optimale vegjetative të pemëve dhe kufizimin e efektit konkurrues të tyre.

ZGJIDHJA

Bëhen trajtime në vjeshtë për të kontrolluar barërat e këqija në rreshta për të gjithë periudhën e dimrit. Efekti i mulçerimit, që sigurohet nga tharja progresive e barërave të këqija, pengon mbirjen e hershme të barërave të këqija në pranverë.



Koha: trajtime pranverore e verore si dhe trajtime në vjeshtë

Doza: 5 - 7.5 L/ha

Shenim: Maksimumi 2 trajtime në vit

Vazhdohet në pranverë me trajtim për luftimin e barërave të këqija graminore e gjethegjëra një, dy e shumëvjeçare si dhe për tharjen e thithakëve. Kjo ndërhyrje, nëse është e nevojshme, mund të përsëritet gjatë verës.

Përqëndrohu në:

BASTA - 15

Me një trajtim të vetëm me Basta-15 mund të luftohen barërat e këqija graminore e dykotiledone si dhe thithakët. Basta-15 duhet të përdoret në rreshtin e pemëve ose rreth pemëve të veçanta, duke përdorur sprucatorë të përshtatshëm për të evituar rënien e solucionit spërkatës mbi pjesët e gjelbra të pemëve.

Programi i trajtimeve të dardhës (Sëmundjet)



BBCH 31



55



61



65



69



72



74



85

Luna
EXPERIENCE

NATIVO

ZATO PLUS

Luna
EXPERIENCE

Aliette

Folicur
EW 250

Antracol
70 WG

Aliette

ZATO

Aliette

SËMUNDJET

- Kroma
- Njillozia kafe
- Bakteriozat
- Kanceri i degëve
- Kalbëzimet në ruajtje

Programi i trajtimeve të dardhës (Dëmtuesit)



BBCH 31

55



61



65



69



72



74



85

DËMTUES:

- Psilla
- Breshkëzat
- Hoplocampa
- Krimbi
- Merimanga e kuqe/
këpushat
- Qëndistarët
- Krimbi i degëve

caLypso®

decis®
envydor®

decis®
MOVENTO®

envydor®

Confidor

Zgjidhje per mbrojtjen Dardha

Shënime

A series of horizontal dashed lines for writing notes.

Zgjidhje per mbrojtjen Dardha

Shënime

A series of horizontal dashed lines for writing notes.



Bayer CropScience